



Trajneri i Partizanit, Hasan Lika ishte shume i kenaqur me rezultatin e arritur duke vleresuar lojen e lojtareve dhe te gjithë skuadres qe ndejten te bashkuar pas asaj krize rezultatesh negative qe kaloi Partizani. “Zhvilluam nje ndeshje te mire duke perfituar edhe nga zbulimi i kundershhtarit ne kerkim te barazimit. Futbollistat dhane maksimumin duke treguar qe jemi ekip i bashkuar. Ne momentin e veshtire qe kaloi skuadra qendruam te bashkuar te gjithë sebashku si lojtaret, stafi, drejtuesit dhe tifozat na mbeshteten gjithmone. Patem krize rezultatesh por jo loje, sepse loje kemi prodhuar por nuk patem rrezultatet qe priteshin. Besoj qe nuk i kemi zgjidhur te gjitha problemet me kete fitore sepse kundershhtarët tani do te impenjohen me teper. Kemi besuar por secili prej lojtareve duhet te vazhdoje tek aftesite e tij dhe te njeri-tjetrit dh eta tregojne ne loje. Po te humbisnim do te jepja doreheqjen sepse du ate miren e Partizanit”, theksoi Lika pas fitores se bujshme 3-0 ndaj Teutes